



Bashkimi i Sindikatave të Pavarura Tiranë në takim të organizuar në Hotel "Tirana International" më 01.11.2014 vendosi që nëse Qeveria nuk dialogon me BSPSH për çmimin e energjisë elektrike, atëherë të mos ndalen protestat për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve.

#### **Fjala e Presidentit të BSPSH Gëzim Kalaja**

"Ky Aktiv mblidhet në zbatim të vendimeve të Këshillit Kombëtar të BSPSH i cili i është drejtuar Kryeministrit Rama për t'u ulur në tavolinën e bisedimeve në lidhje me vendimet e saj që kanë të bëjnë me rritjen e çmimit të energjisë elektrike, gjë që është e papranueshme për BSPSH, punonjësit dhe qytetarët e Shqipërië dhe për lejet e ndërtimit të pezulluara që kanë sjellë një kolaps në industrinë e ndërtimit. Në lidhje me çmimin e energjisë elektrike i kemi ripërsëritur kërkesën kryeministrit më 23 shtator 2014, i jemi drejtuar Entit Rregullator të Energjisë. Jetojmë në një realitet konfuz. Deklarimet e kryeministrit dhe ministrave janë kontraditore. Ne jemi kundër abuzuesve, kundër vjedhjes së energjisë elektrike, i bëjmë thirrje qytetarëve shqiptarë që të jenë të kujdesshëm në zbatimin e ligjit dhe punonjësve, që ato të bëjnë pagesën e

energjisë. Qeveria dhe kryeministri premtuar punësimin e shqiptarëve pasi të merrej pushteti, por si paraqitet realiteti? A e din sot kryeministri se sa është përbindja e papunësisë në vend? A e din raportin e pagave që kanë punonjësit e Shqipërisë krahasur me ato të rajonit ballkanik dhe europës ku ne pretendojmë të hyjmë?. BSPSH ka denoncuar publikisht dhe në mënyrë konstante marrëveshjen e qeverisë me FMN e cila solli këto pasoja. BSPSH deklaronte se pas nënshkrimit të marrëveshjes me FMN do të ketë pasoja të cilat u vërtetuan që me rritjen e moshës së pensionit për burrat dhe gratë, vendosjen e 21 taksave të reja. Kur ne deklaranim se do të rritet çmimi i energjisë elektrike, ekzekutivi deklaronte se kjo nuk na është kërkuar nga FMN dhe se qeveria nuk do ta rrisë çmimin e energjisë. Pra, tani po dalin ato që deklaroi BSPSH-ja. Ne kemi sensibilizuar anëtarësinë tonë se nëse kryeministri deri më 12 nëntor nuk prononcohet për datën e takimit me BSPSH-në, ne jemi në të drejtën tonë të imponuar nga heshtja e qëllimshme e qeverisë dhe nga mosdëshira e kryeministrit për t'i bërë thirrje punonjësve, forcave politike dhe qytetarëve për të dalë në protestë në të gjitha sheshet e Shqipërisë. Ne nuk e dëshirojmë protestën, ne dëshirojmë që problemet të zgjidhen në tavolinën e bisedimeve, ne do ta mirkuptojmë qeverinë për kërkesat që ajo nuk ka mundësi t'i përmbushë në mënyrë të menjëhershme, por kryeministri duhet të dialogojë me BSPSH-në. Strategjia jonë është dialogu dhe ulja në tavolinën e bisedimeve. *Heshtjen e kryeministrit dhe qeverisë për t'u takuar me BSPSH-në, e konsiderojmë të qëllimshme nëse nuk realizohet dhe imponuese kundër dëshirës tonë për të dalë në shesh, për të protestuar.*

Kjo duhet kuptuar nga të gjithë ne, është një kosto shumë e madhe për t'i dalë zot punonjësve të Shqipërisë që na kanë votuar. BSPSH ka për mision mbrojtjen e anëtarësisë së saj dhe qytetarëve dhe do ta bëjë. I bëjmë thirrje anëtarësisë sonë, forumeve drejtuese, studentëve, shoqërisë civile, partive politike pa dallim t'i bashkohen protestës së BSPSH në mbrojtje të të drejtave tona dhe të familjeve tona. BSPSH di t'i bëjë shumë mirë protestat ashtu siç i ka bërë deri më tani.

Një ditë para Aktivit të BSP Tiranë më 31 tetor 2014, siç u deklarua kreu i BSPSH-së z. Gëzim Kalaja pati një takim me ministrin Erion Veliaj. Sipas ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ky takim bëhet me porosi të Kryeministrit dhe se do t'i transmetohen edhe njëherë kërkesat e BSPSH-së. Çuditshëm me anë të në një shkresë që mban datën 30 tetor 2014 po kjo ministri i kthen përgjigje BSPSH-së. Përgjigje e cila nuk kishte të bënte me kërkesat që ka paraqitur BSPSH-së.



